



Buxhetimi i nevojave partiake

Prioritetet evropiane dhe planifikimi i buxhetit shtetëror në Kosovë



GRUPI PËR STUDIME
JURIDIKE DHE
POLITIKE

Buxhetimi i nevojave partiake: Prioritetet evropiane dhe planifikimi i buxhetit shtetëror në Kosovë

Arbëresha Loxha, GSJP

Korrik 2012

BUXHETIMI I NEVOJAVE PARTIAKE: PRIORITETET EVROPIANE DHE PLANIFIKIMI I BUXHETIT SHTETËROR NË KOSOVË

I. Prapavija

Para së gjithash, integrimi në BE është një proces i udhëhequr nga standardet, i cili përmes formave të ndryshme të komunikimit, kërkon nga vendet e mundshme kandidate të fokusohen si dhe të krijojnë standarde të rëndësishme të ndërtimit të shtetit dhe institucioneve. Megjithatë, për qeveritë shpesh është mjaftë i komplikuar investimi në standarde që avancojnë shtet-ndërtimin dhe forcojnë praktikën e qeverisjes së mirë, sidomos lidhur me praktikën e planifikimit të buxhetit. Me siguri që arsyeja kryesore ndërlidhet me faktin se partitë politike në pushtet e humbasin monopolin e tyre mbi sjelljet e qeverisë dhe administratës. Si pasojë e këtij modeli, në vendet në tranzicion, elitat politike përshtatin buxhetin shtetëror për nevojat e tyre politike/partiake me qëllimin përfundimtar që të sigurojnë kontroll afatgjatë mbi administratën shtetërore, dhe kështu shmangin krijimin e mekanizmave që mund të pengojnë mundësinë e partive të tyre që të mbështesin monopolet dhe interesat partiake.

Planifikimi i buxhetit është një tregues i zotimit vis-a-vis zbatimit të politikave shtetërore, dhe si i tillë duhet të korrespondojë me prioritetet e politikave të shtetit. Në veçanti, buxheti shpreh zotimin e qeverisë ndaj një politike, dhe normalisht tregon nivelin e prioritetit që i është vendosur. Në anën tjetër, një përcaktues i rëndësishëm i suksesit të një vendi të caktuar në adresimin e standardeve të politikave evropiane është niveli i ndërlidhshmërisë dhe mbështetjes së prioritetëve evropiane me buxhetin shtetëror.

Në këtë pikë të diskutimit, analizimi i buxhetit është kyç për vlerësimin e vendimeve të qeverisë mbi alokimin dhe shpërndarjen e burimeve të kufizuara në mesin e prioritetëve konkurrues, si dhe vlerësimin nëse burime adekuate reflektojnë në mënyrë të duhur prioritetet e pranuar. Prandaj, për qëllimin e analizës sonë, është e një rëndësie të madhe të vlerësohet procesi i shpërndarjes së buxhetit gjatë viteve, dhe në mënyrë të barabartë, vendimet për të përcaktuar prioritetet buxhetore, pasi që këto të fundit ndikojnë drejtpërdrejtë në përmbushjen e prioritetëve të integritetit në BE dhe zhvillimit të tregut të brendshëm. Në këtë drejtim, në bazë të gjetjeve të Raportit të Politikave 05/2012, kjo Analizë e Politikave elaboron marrëdhënien në mes të prioritetëve evropiane për Kosovën dhe prioritetëve buxhetore të Qeverisë nga 2007 deri në vitin 2011.

Shkurtimisht, analiza argumenton se përcaktimi i prioritetëve buxhetore nuk pasqyron agjendën evropiane të Qeverisë së Kosovës, si një mjet i politikave për të arritur transformimin institucional të vendit si dhe zhvillimin afatgjatë. Përveç kësaj, raporti vërteton faktin që Kosova ka një alokim të buxhetit të orientuar politikisht në vend të një buxheti që adreson prioritetet evropiane. Në veçanti, raporti vërteton që renditja e prioritetëve evropiane në agjendën qeveritare dhe pjesëmarrja e tyre në buxhet nuk reflekton një zotim serioz kundrejt këtij procesi.

II. Metodologjia

Për qëllim të kësaj analize, ne përdorim shumat e buxhetit siç paraqiten në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) dhe raportohen në Raportet Vjetore Financiare dhe Buxhetin e Republikës së Kosovës. Duke marrë parasysh që disa të dhëna lidhur me IKAP dhe Administratën Tatimore nuk janë të disponueshme, ne prezantojmë shumat siç paraqiten në Tabelat Buxhetore për vitet përkatëse. Ne llogarisim rritjen nominale nga viti në vit (VnV) në ndarjet buxhetore për të përcaktuar se sa është rritur/ulur shuma e alokuar e buxhetit për një organizatë buxhetore nga viti në vit në baza nominale. Për të llogaritur rritjen nga VnV në alokimet buxhetore për organizatat buxhetore (më tutje OB-të), formula në vijim është aplikuar:

Shkalla e rritjes = (alokimi i vitit aktual – alokimi i vitit paraprak) / alokimi i vitit paraprak X 100.

Në anën tjetër, për të llogaritur alokimin real ne e kemi ndarë secilin alokim buxhetor nga deflatori për vitin përkatës. Deflatori i çmimeve llogaritet duke pjesëtuar Indeksin e Çmimeve të Konsumeve (ICK)¹ me 100. Për secilin vit, ne e kemi ndarë alokimin nominal të buxhetit për OB-të me deflatorin e çmimeve, kështu kemi konvertuar këto shumat në vlera reale.

$$\text{Alokimi real} = \text{Alokimi nominal} / \text{deflatori i çmimeve}$$

Shkalla e Rritjes Reale Vjetore nga VnV llogaritet duke ndjekur formulën e njëjtë për shkallën e rritjes nominale, duke përdorur të dhënat reale të alokimeve. Shkalla e Rritjes Mesatare Vjetore Reale është llogaritur duke pjesëtuar shkallën e mbledhur të rritjes reale me numrin e shkallës së llogaritur të rritjes vjetore.

Përderisa, pesha në Buxhetin e Përgjithshëm të Shtetit (më tutje BPSH) llogaritet duke pjesëtuar buxhetin e alokuar të OB-ve me BPSH për vitin përkatës dhe duke shumëzuar shumën e gjeneruar nga kjo me 100.

$$\text{Pesha në BPSH} = (\text{alokimi i buxhetit për OB-të për vitin X} / \text{BPSH për vitin X}) \times 100$$

III. Konteksti: Procesi i buxhetit në Kosovë

Në Kosovë, procedura vjetore për formulimin e buxhetit fillon në Prill dhe rregullohet me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (2012/04-L-116). Ai përshkruan dhe rregullon, mes tjerash, afatet kohore dhe procedurat për përgatitjen e KAMSH.² Procesi i buxhetit konsiston në tri faza kryesore: Formulimin e buxhetit, aprovimin/miratimin dhe zbatimin.

Në fazën e parë, Ministria e Financave (më tutje MF) është përgjegjëse për të përgatitur buxhetin e Republikës së Kosovës dhe më vonë për t'ia parashtruar Qeverisë për miratim. Në nivelin lokal, kryetari i komunës është autoriteti kompetent për të përgatitur buxhetin komunal dhe për t'ia paraqitur komisioneve komunale dhe kuvendit komunal për aprovim. Fillimisht, bazuar në strategji dhe në tavanet maksimale, MF është e detyruar të ju ofrojë të gjitha organizatave buxhetore

¹ Vlerat ICP reflektojnë vlerat e publikuara nga Instituti i Statistikave të Kosovës për vitet përkatëse.

² Gjithashtu ofron një pasqyrë të trendeve të fundit fiskale, parashikimeve, perspektives makroekonomike për periudhën trevjeçare.

udhëzime në formë të qarkoreve buxhetore. Organizatat Buxhetore përgatisin propozime të kërkesave buxhetore në bazë të qarkores buxhetore. Qarkorja buxhetore për komuna duhet të ju dorëzohet komunave nga ministria më së largu më 30 shtator. Pavarësisht që kanë qarkore buxhetore të ndara, procedurat për përgatitjen dhe zbatimin e buxhetit, të përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, gjithashtu aplikohen edhe për komuna. Për shkak të mungesës së fondeve, qarkorja e parë buxhetore shpesh pasohet me dëgjime buxhetore (më tutje DB). Në bazë të përshtatjeve si konkluzion i DB-ve, duhet të përgatiten buxheti i propozuar dhe arsyetimi i buxhetit. Ministria duhet të përgatisë projekt buxhetin.

Qarkorja e tretë është ajo finale, dhe sigurisht është Ministria ajo që komunikon projekt buxhetin final. Ajo pastaj e dorëzon propozimin për buxhet dhe Projektligjin për alokimin e buxhetit për miratim në qeveri. Në anën tjetër, qeveria duhet të dërgojë projekt buxhetin për aprovim në Kuvend më së largu më 31 tetor të vitit fiskal aktual. Seancat e diskutimit publik në Kuvend duhet të mbahen gjatë dhjetorit. Ministri i financave, duhet të prezantojë projekt buxhetin para deputetëve në Kuvend në leximin e parë. Pas leximit të parë projektligji kalon në komisionin parlamentar funksional dhe komisionet tjera parlamentare poashtu kanë të drejtë të propozojnë amandamente.. Më pas komisioni për buxhet e harton raportin me amandamente dhe e dorëzon për lexim të dytë në seancë plenare. Gjatë leximit të dytë votohet secili amandament dhe në fund votohet projektligji si tërësi. Buxheti i Republikës së Kosovës duhet të aprovohet më së largu më 31 dhjetor.


IV. Trendet nominale dhe reale të buxhetit sektorial dhe pesha në Buxhetin e Përgjithshëm të Shtetit: Problemet dhe Analizat

Raportet e Progresit të KE-së kanë identifikuar vazhdimisht jo efektivitetin e administratës publike të Kosovës, korrupsionin, dhe institucionet e dobëta për sundimin e ligjit si disa nga pengesat kryesore në ndërtimin e mekanizmave shtetërorë të qëndrueshëm/efikas si dhe avancimin e procesit të shtet-ndërtimit. Përveç kësaj, ndërhyrjet politike në drejtësi dhe ndërhyrja/frikësimi në proceset e prokurimit publik, sipas Raporteve të Progresit të KE-së për Kosovën pengojnë efikasitetin e zbatimit të reformave ligjore, politike edhe ekonomike dhe progresin e Kosovës drejt Integritetit Evropian. Megjithatë, përveç nevojës për të adresuar shumë sfida/prioritete që ndihmojnë avancimin/përmirësimin e gjendjes në disa sektorë dhe institucione, në këtë Analizë të Politikave ne identifikojmë dhe theksojmë disa nga sfidat që në vazhdimësi adresohen nga raportet e KE-së (siç tregon fig. I), dhe argumentojë që buxheti nuk adreson fare kritikën në rritje të KE-së drejt performancës së Kosovës në këto fusha të politikave. Është e qartë se prioritetet e BE-së të shumëpërfolura nuk janë përkthyer në prioritetet reale buxhetore, pasi ne identifikojmë që nuk ka asnjë ndërlidhje mes prioritetëve të deklaruar dhe alokimit të buxhetit.

Fig. 1: Shpjegimi i qëndrimeve të KE-së përballë reformave kyçe					
Viti	Prioritetet që duhet të adresohen në bazë të Raportit të Progresit të KE-së	Prioritetet e Raportit të Progresit të KE-së (të bëra vazhdimisht gjatë viteve)			Progresi VnV
	PO/JO	Sistemi gjyqësor	Prokurimi publik	Reforma e administratës publike	▲ Përmirësimi (P) ▼
2007	PO	a) Sistemi gjyqësor vazhdon të jetë i dobët dhe efikasiteti ka nevojë të rritet;	a) Dispozitat mbi koncesionet në kornizën ligjore aktuale dallojnë shumë nga acquis;	a) Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të përfunduar kapacitetin e institucioneve në krye të reformës së administratës publike si dhe lejimit të transferimit të dijës dhe praktikave më të mira në të gjithë rajonin;	↓ K
2008	PO	b) Menaxhimi i të dhënave dhe rasteve është ende i dobët; ka një numër të konsiderueshëm të rasteve gjyqësore të grumbulluara;	b) Zyrtarët e prokurimit në Kosovë mbeten të ekspozuar ndaj ndërhyrjeve dhe frikësimit;	b) Administrata publike dhe kapaciteti koordinues i organeve publike në Kosovë vazhdojnë të mbesin të dobëta;	↓ K
2009	PO	c) Ky është një shqetësim serioz lidhur me pavarësinë e gjyqësorit;	c) Kapaciteti administrativ dhe mekanizmat koordinues të palëve kryesore të përfshira në sistemin e prokurimit publik ende kanë nevojë për forcim, në veçanti për të reduktuar mundësinë për korrupsion;	c) Shërbyesit civilë vazhdojnë të jenë të ndjeshëm ndaj ndërhyrjeve politike, korrupsionit dhe nepotizmit.	↓ K
2010	PO	d) Ndikimi politik në punën e gjyqësisë është ende një shqetësim;	d) Tri organet e prokurimit publik duhet të koepërojnë në mënyrë me efikase;		↓ K
2011	PO	e) Përmirësimet janë të nevojshme në efikasitetin e procedurave gjyqësore dhe zbatimin e vendimeve;			↓ K
		f) Bashkëpunimi mes zyrës së prokurorit dhe policisë është i kufizuar.			↓ K
					↓ Keqësimi (K) ↓

Në përgjithësi, bazuar në gjetjet e Raportit të Politikave 05/2012 të GSPJ, ne prezantojmë analizat e trendeve buxhetore të OB-ve (përgjegjëse për të adresuar sfidat/prioritetet në sektorët e definuar si

prioritet nga BE për Kosovën gjatë viteve në sektorët e përzgjedhur), dhe peshën/pjesëmarrjen e buxhetit të OB-ve në buxhetin e përgjithshëm shtetëror, për të vlerësuar nëse sektorëve të rëndësishëm (populiste) është duke u dhënë prioritet nga partia politike në pushtet në krahasim me prioritetet e politikave të shtet-ndërtimit. Për shembull, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit shtetëror kanë treguar rritje mesatare të vazhdueshme (përveç vitit 2010)³ gjatë periudhës 2007-2011, një ngritje mesatare nominale dhe reale vjetore prej 20%, respektivisht 15.12% (shih grafikun I). Rritja në përqindje, tregon një rritje të alokimit të buxhetit nga ana e qeverisë ndaj disa sektorëve; megjithatë, proporcioni i shpenzimeve qeveritare të alokuara ndaj shumicës së këtyre sektorëve ishte dhe vazhdon të mbetet i papërfillshëm.



Grafiku I: Trendi i Shpenzimeve të Buxhetit Shtetëror Nominal dhe Real gjatë viteve 2007-2011 (%)

Rritja e buxhetit të përgjithshëm të shtetit, në princip, duhet të reflektohet në rritjen e buxhetit për OB-të me prioritet BE-në, megjithatë proporcioni i rritjes në masë të madhe i dedikohet prioritetëve partiake të qeverisë së vërtetë. Në përgjithësi, shpërndarja e fondeve buxhetore duhet të balancohet dhe të mbështesë sektorët që janë të rëndësishëm për ndërtimin e shtetit dhe Integrimin Evropian me buxhet adekuat. Prandaj, supozimi megjithatë është se rritja e buxhetit të OB-ve është tregues i rritjes së vëmendjes së qeverisë ndaj këtyre OB-ve. Me të thënë këtë, për shkak të rritjes vjetore të buxhetit shtetëror, në analizën në vijim, ne vlerësojmë nëse OB-ve me prioritet Evropian të cilave u është rritur buxheti vjetor, hasin si rezultat një ngritje të pjesës/peshës së tyre në buxhetin shtetëror.

Prandaj, analiza tregon që prioritetet/sfidat evropiane morën vëmendje buxhetore të vogël/minimale, pasi shumica e tyre kapin shumë rreth/më pak se 1% të buxhetit të përgjithshëm shtetëror gjatë periudhës 2007-2011. Kjo është në masë të madhe si rezultat i dështimit të qeverisë për të projektuar një buxhet të bazuar në shtet-ndërtim dhe prioritete të integritimit Evropian, duke u

³ Për më tepër shih grafikun 6.

koncentruar në masë të madhe për të financuar prioritetet partiake. Për më tepër, nga një perspektivë tjetër, ky angazhim i dobët i qeverisë ka rezultuar në sfida të shumta, duke shfaqur përpjekjet jo të kënaqshme të angazhimit të qeverisë për të shtyrë përpara prioritetet evropiane.

Në veçanti, edhe pse buxheti shtetëror tregon rritje të vazhdueshme (përveç vitit 2010), shumica e OB-ve në fjalë janë në gjendje më të keqe vis-a-vis pjesëmarrjes së tyre në buxhetin e përgjithshëm shtetëror kur krahasohen me vitin 2007.⁴ Në anën tjetër, kjo nënkupton një ulje të prioriteteve Evropiane në lidhje me agjendën qeveritare dhe listën e saj të prioritetëve buxhetore. Siç tregon Tabela 4, infrastruktura është qartazi e vendosur në maje të prioritetëve të qeverisë pasi proporcioni i buxhetit të Ministrisë së Infrastrukturës/Transportit dhe Telekomunikacionit në buxhetin e përgjithshëm shtetëror u rrit nga 4.68% në 18.3% në pesë vitet e fundit. Megjithatë, siç shpalos Tabela 7, pavarësisht nga rritja nominale e buxhetit të tyre, shumica e OB-ve kishin ulje në pjesëmarrjen e tyre në BPSH.

Tabela 1: Ministria e Infrastrukturës/Transportit dhe Telekomunikacionit									
	2007/2008		2008/2009		2009/2010		2010/2011		
	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	
Ndryshimi Nominal dhe Real VnV %⁵	289.7	256.4	15.5	18.3	29.0	24.7	33.1	24.0	
	2007	2008	Ndryshim nga viti i kaluar	2009	Ndryshim nga viti i kaluar	2010	Ndryshim nga viti i kaluar	2011	Ndryshim nga viti i kaluar
Pesha në Buxhetin e Përgjithshëm të Shtetit (%)	4.7	11.3	↑	12.0	↑	15.4	↑	18.3	↑

Për më tepër, analiza tregon që rritja e buxhetit të përgjithshëm të shtetit është reflektuar në rritjen e buxhetit për disa OB në baza nominale; sidoqoftë, ky nuk është rasti me shumicën nga to. Viti 2008 ka qenë mjaft përfitues për shumicën e OB-ve me të cilat përfshihen në analizë, megjithatë, viti 2009 nuk ka qenë 'bujar' sidomos me Agjencionin e Prokurimit Publik, Policinë, Prokurorin e Shtetit dhe IKAP-in, për ti cekur disa nga institucionet kompetente kyçe për të adresuar prioritetet kryesore të integriteteve evropiane (shih tabelën 2, 3 kolona 2 dhe 3, dhe grafikun 8).


Në vitin 2010 dhe 2011, ulja e buxhetit vjetor ka qenë më e theksuar dhe e ashpër për shumë OB krahasuar me vitet paraprake (shih tabelën 2, 3, 4, 6 kolona 4 dhe 5, dhe grafikun 8). Përveç kësaj, provat tregojnë një rritje të buxhetit të disa OB-ve me prioritet evropian, në shumë raste ka qenë shumë joproporcional për përqindjen e rritjes së buxhetit të përgjithshëm të shtetit siç është rasti me institucionet e Prokurimit Publik (shih grafikun 2 për shembull).

Në kontrast, si gjithmonë gjatë këtyre viteve, sektori i infrastrukturës ka pranuar një rritje prej 33%, megjithatë, në shkallë me të ulët se rritja e vitit 2008 (290%). Kjo është në kontrast të

⁴ Shih grafikun 3,4 dhe 9 dhe tabelat 5 & 6


⁵ Ndryshimi i përqindjes nominale dhe reale nga viti në vit tregon trendin e buxhetit të OB-së përkatëse nga viti i kaluar (rrije/rënie). Për më shumë informata se si i kemi llogaritur trendet nominale dhe reale referohuni në seksionin e metodologjisë. Përderisa për alokimet reale dhe nominale të buxhetit shih Tabelën 8.

theksuar me rritjen e buxhetit të përgjithshëm të shtetit në vitin 2011, i cili u rrit për vetëm 11.8% mbi buxhetin e vitit 2010.



Grafiku 2: Ndryshimi % VnV i institucioneve të Prokurimit Publik dhe Anti-Korrupsionit në krahasim me Buxhetin e Përgjithshëm të Shtetit

Sigurisht, nëse llogarisim inflacionin, disa përmirësime në fondet e alokuara dhe rritjen e shpenzimeve, që të dyja të prezantuara nga qeveria si angazhime serioze drejt Prioriteteve Evropiane, dalin të jenë një zhgënjim. Duke prezantuar llogaritjen e vlerave reale, rezultatet treguan që alokimet e buxhetit për shumë OB me prioritet evropian të jenë më të vogla se ato nominale.⁶ Një shembull i tillë është buxheti vjetor i Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2011 që pati rritje nominale për 11.2%, por në fakt pranoi një rritje reale prej vetëm 3.55% (shih tabelën 3). Ndërsa, për më tepër, buxheti i Agjencionit të Prokurimit Publik pavarësisht rritjes në terma nominal, fuqia e saj blerëse në fakt ka rënë, pasi në terma real buxheti u zvogëlua për 4.11% (shih tabelën 3). Kjo është sidomos e vërtetë me shumë OB me prioritet evropian gjatë viteve (shih tabelat më poshtë).



Grafiku 3: Pesha (%) e OB-ve të sektorit të drejtësisë në Buxhetin e Përgjithshëm Shtetëror për vitin 2011

⁶ Shih kolonat e vlerave reale dhe nominale në tabelat përkatëse (2,3,4,6 dhe grafiku 8)

V. Alokimi i buxhetit sektorial dhe pjesëmarrja në buxhetin e përgjithshëm shtetëror gjatë viteve

A) Sektori i Drejtësisë

Raporti i Zgjerimit i KE (2010-2011) ngritë nevojën për të zhvilluar plane konkrete për të trajtuar reformën në drejtësi, dhe për më tepër thekson nevojën për alokimin më të gjerë të burimeve financiare. Sipas raportit të Progresit të KE-së, "Kosova është ende në një fazë të hershme në adresimin e prioriteteve në fushën e drejtësisë."⁷ Pavarësisht nga kjo, siç tregohet në tabelën 2, buxheti i alokuar sektorit të drejtësisë gjatë viteve është shumë i ulët dhe larg nga të qenit i mjaftueshëm dhe i kënaqshëm për nevojat e këtij sektori. Duke konsideruar rolin e Ministrisë së Drejtësisë në ndërtimin e një sistemi gjyqësor dhe prokurorial efikas, të pavarur dhe të paanshëm, harmonizimin e ligjeve me standardet e BE-së, dhe zhvillimin e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, buxheti i saj peshon vetëm 1.38% të buxhetit të përgjithshëm të shtetit në vitin 2011, dhe në mesatare vetëm 1.7% (shih grafikun 3) nga viti 2007 deri 2011. Situata është edhe me e keqe me Prokurorin e Shtetit, Sekretariatit e KGJK-së⁸ dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës, si aktorë kyç në promovimin e drejtësisë për të gjithë qytetarët dhe sigurimin e pavarësisë dhe paansisë së sistemit të drejtësisë. Secila ndajnë vetëm një pjesë të vogël të buxhetit shtetëror (shih grafikun 3), dhe për më tepër, të gjitha së bashku kanë vetëm 1.56% të buxhetit shtetëror në vitin 2011 (shih grafikun 7). Siç kemi treguar më lartë, OB-të përgjegjëse për të adresuar prioritetet evropiane në sektorin e drejtësisë janë të nën-buxhetuara në shkallë të madhe. Për më tepër, buxheti i tyre dhe pjesëmarrja në BPSH janë në kontrast të plotë me atë të infrastrukturës, edhe një herë duke theksuar prioritetin real të qeverisë. Kjo, në anën tjetër, tregon që nuk ka pasur angazhim serioz nga ana e qeverisë për të investuar në adresimin e këtyre prioriteteve, dhe mbështetja financiare e sektorit të drejtësisë ose ka qenë e pamjaftueshme ose ka rënë edhe me tutje.

Tabela 2: Ndryshimi nominal dhe real % VnV

Sektori i Drejtësisë	2007/2008		2008/2009		2009/2010		2010/2011		Shkalla e rritjes reale
	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	
Ministria e drejtësisë	20.8	10.5	19.51	22.45	-0.67	-4.00	-8.8	-15.0	3.5
Dep. i Drejtësisë/Prokurori i shtetit	-17.1	-24.2	-30.8	-29.09	-89.16	-89.52	4098.3	3812.2	917.4
Instituti Gjyqësor i Kosovës	25.1	14.4	79.3	83.76	-5.77	-8.92	-11.2	-17.2	18.0


⁷ COM(2010) 660. Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian dhe Këshillin. Strategjia e Zgjerimit dhe Sfidat Kryesore 2010-2011.

⁸ Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	32.2	20.9	18.3	20.1	3.86	0.38	20.1	11.87	13.6
---	------	------	------	------	------	------	------	-------	------

B) Anti-Korrupsioni

Raportet e KE-së (shih fig. 1) konsiderojnë korrupsionin si një problem të vazhdueshëm dhe një sfidë serioze për Kosovën. Pavarësisht disa përmirësimeve, në veçanti në kornizën ligjore kundër korrupsionit, mekanizmat kundër korrupsionit konsiderohen të pakompletuar dhe jo në përputhshmëri me standardet e BE-së. Nga viti 2008, Raportet e Progresit të KE-së theksojnë disa prioritete që autoritetet qeveritare duhet t'i adresojnë, si themelimi i mekanizmave për të lehtësuar transparencën e çështjeve korruptive; nevojën për koordinim më të mirë mes disa institucioneve të përfshira në luftimin e korrupsionit dhe eliminimin e ndërhyrjeve politike në rastet/proceset e korrupsionit. Në këtë drejtim, grafiku 4 tregon që buxheti i Agjencionit Kundër Korrupsionit (AKK) gjatë viteve nuk ka absorbuar as edhe 1 përqind të buxhetit të përgjithshëm të shtetit dhe pjesëmarrja e tij ka rënë vazhdimisht gjatë viteve (përveç në vitin 2010). Për më tepër, si pasojë e këtij trendi, AKK është në gjendje më të keqe në vitin 2011, nëse merret parasysh pesha në buxhetin e përgjithshëm të shtetit krahasuar me vitin 2007 (shih grafikun 4). Si shtesë, ndryshimi në përqindje në buxhetin e AKK është në disproporcion kundrejt rritjes në përqindje të buxhetit të përgjithshëm të shtetit⁹. Për këtë arsye, nuk është për t'u habitur fakti se deri më sot nuk është parë ndonjë çështje korruptive e trajtuar me sukses nga autoritetet, duke mbështetur argumentin tonë që qeveria ka tendencë për ti injoruar këta sektorë, kryesisht për shkak të interesave partiake.



⁹ Shih grafikun 2

Grafiku 4: Pjesëmarrja (%) në buxhetin e përgjithshëm të shtetit të institucioneve të Prokurimit Publik dhe Kundër-Korrupsionit gjatë viteve 2007-2011

C) Prokurimi Publik


Sa i përket prokurimit publik, raportet e KE-së (shih fig 1) pranojnë se zbatimi i ligjeve ekzistuese është një problem serioz. Raportet e tilla theksojnë nevojën për të forcuar rolin e zyrtarëve të prokurimit publik në mënyrë që të sigurohet monitorim i duhur i zbatimit të kontratave të prokurimit. Sipas raporteve të njëjta, pavarësia dhe profesionalizmi në sistemin e prokurimit publik mbetet sfidë serioze, dhe korrupsioni në këtë sektor mbetet një shqetësim serioz. Dispozitat e ligjeve të Kosovës mbi koncesionet dallojnë shumë nga standardet evropiane.

Tabela 3: Ndryshimi nominal dhe real % VnV									
Sektori Sundimi i Ligjit	2007/2008		2008/2009		2009/2010		2010/2011		Shkalla mesatare e rritjes reale
	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP)	-1.77	-11.3	-4.79	-2.45	-6.52	-9.6	11.2	3.54	-4.97
Agjencioni i Prokurimit Publik (APP)	7.228	-1.96	-5.01	-2.67	0.76	-2.61	2.90	-4.11	-2.84
Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)					-45.6	-47.4	-4.5	-11.0	-29.22
Agjencioni Kundër Korrupsionit (AKK)	19.39	8.42	10.50	13.22	-0.04	-3.38	5.95	-1.27	4.25
Policia	4.24	-4.88	-8.77	-6.53	15.99	12.11	17.7	9.67	2.59

Buxheti i alokuar për prokurimin publik është shumë i pamjaftueshëm, përderisa progresi në këtë fushë është jetësor për të përmirësuar qeverisjen e sektorit publik dhe hapjen e sektorit ndaj konkurrencës. Buxheti i pamjaftueshëm për sektorin e prokurimit publik është një nga problemet e shumta, i ndjekur nga mungesa e kapaciteteve administrative në Agjencionin e Prokurimit Publik, procedurat e drejtpërdrejta të tenderimit dhe mungesës së konkurrencës. Shkalla e rritjes mesatare vjetore reale të buxhetit të alokuar për institucionet e prokurimit publik ka qenë negative,¹⁰ me Organin Shqyrtues të Prokurimit duke pasur më të ulët me 29.22% (shih tabelën 3, kolona e fundit). Siç tregon grafiku 4, trendi i përgjithshëm i peshës së tri institucioneve të prokurimit publik në buxhetin e përgjithshëm shtetëror ka qenë negativ, ku gati çdo vit pesha në relacion me buxhetin e përgjithshëm shtetëror ka rënë. Për më tepër, bashkë me Agjencionin Kundër Korrupsionit, pjesëmarrja e tyre në buxhetin e përgjithshëm të shtetit ka arritur vetëm 0.07% të BPSH-së gjatë vitit 2011 (shih grafikun 5). Një buxhet i tillë është sigurisht jo adekuat dhe i paaftë për të përmbushur

¹⁰ Përveç KRPP në vitin 2010/2011

sfidat e shumta në këtë sektor, sidomos ato që ndërlidhen me prioritetet evropiane. Me të thënë këtë, lidhja direkte mes luftës së korrupsionit në përgjithësi dhe keqpërdorimeve në prokurimin publik shpjegojnë neglizhencën e qeverisë për të investuar në këta sektorë.




Grafiku 5: Pjesëmarrja (%) e Institucioneve të Prokurimit Publik dhe Agjencionit Kundër Korrupsionit në Buxhetin e Përgjithshëm të Shtetit në vitin 2011.

D) Zhvillimi ekonomik

Sundimi i dobët i ligjit, korrupsioni, pasiguria mbi të drejtat pronësore dhe normat e larta të interesit vazhdojnë të dëmtojnë mjedisin biznesor dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë, siç është vënë në pah nga raporti i progresit për Kosovën. Për më tepër, sektori informal mbetet një sfidë e rëndësishme. Përkundër kësaj, buxheti i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Agjencionit të Konkurrencës dhe veçanërisht i Administratës Tatimore, si OB me rëndësi të madhe për prioritetet evropiane, secila ndajnë më pak se 1 përqind të buxhetit të përgjithshëm të shtetit.¹¹

¹¹ Shih Tabelën 5



Grafiku 6: Shpenzimet e Buxhetit të Përgjithshëm të Shtetit gjatë viteve 2007-2011.


Tabela 4: Ndryshimi nominal dhe real % VnV								
Zhvillimi Ekonomik	2007/2008		2008/2009		2009/2010		2010/2011	
	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	59.53	45.91	60.5	64.45	4.8	1.3	-24.6	-29.8
Administrata Tatimore			13.41	16.21	0.76	-2.62	1.28	-5.62
Komisioni Kosovar i Konkurrencës					18.45	14.48	-1.47	-8.18

Për më tepër, buxheti real i MTI-së, Agjencionit të Konkurrencës dhe Administratës tatimore është zbritur në vitin 2011 për 29.77%, 8.18% dhe 5.62% respektivisht (shih tabelën 4), duke përfshirë një rënie në listën e prioriteteve të qeverisë, pavarësisht nga sfidat e mëdha në vend.

Tabela 5: Pesha në Buxhetin e Përgjithshëm të Shtetit (%) gjatë viteve dhe trendi i pjesëmarrjes në buxhet në krahasim me vitin paraprak									
	2007	2008	Trend	2009	Trend	2010	Trend	2011	Trend
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	0.47	0.49	↑	0.65	↑	0.72	↑	0.48	↓
Administrata Tatimore		0.53		0.49	↓	0.52	↑	0.47	↓
Komisioni Kosovar i Konkurrencës				0.01		0.02	↑	0.01	↓


E) Administrata Publike

Studimi tregon se buxheti dhënë për IKAP që nga themelimi i tij ka qenë mjaft i vogël dhe i pamjaftueshëm. Për më tepër, buxheti i tij ka rënë vazhdimisht (si në terma nominalë dhe realë) gjatë periudhës 2007-2009 (shih grafikun 8), duke ilustruar një disharmoni në mes të rritjes së kritikave të raporteve të KE-së për të adresuar shumë sfida lidhur me administratën publike dhe profesionalizmit të ulët në radhët e shërbyesve civilë.




Grafiku 7: Pjesëmarrja (%) e Prokurorit të Shtetit, Sekretariatit të KJC¹² dhe Institutit Gjyqësor në Buxhetin e Përgjithshëm të Shtetit në vitin 2011.

Siç tregon grafiku 9, pjesëmarrja e IKAP-it në buxhetin e përgjithshëm të shtetit është shumë e vogël; duke pasur parasysh që pjesëmarrja e IKAP-it nuk është as 1 % e buxhetit të përgjithshëm të shtetit. Për më tepër, IKAP është në gjendje më të keqe në vitin 2011 duke konsideruar peshën e tij në buxhetin e përgjithshëm të shtetit krahasuar me vitin 2007. Prandaj, ky studim tregon se përpjekjet/angazhimet e Qeverisë për të investuar në ndërtimin e kapaciteteve të shërbyesve civilë mund të konsiderohen mjaft të dobëta.



Grafiku 8: Buxheti i IKAP-it: Ndryshimi nominal dhe real % VnV

¹² KGJK- Këshilli Gjyqësor i Kosovës



Grafiku 9: Pesha e IKAP-it në buxhetin e përgjithshëm të shtetit gjatë viteve (%)

F) Mjedisi

Mjedisi i Kosovës është i dëmtuar rëndë nga ndotja, që bëhet kryesisht nga termocentralet (të vlerësuara me 25 ton hi dhe pluhur në orë), duke tejkaluar dukshëm standardet evropiane, mbi 74 herë. Deri tani, Kosova ka treguar sukses në transpozimin e direktivave të BE-së, megjithatë zbatimi i tyre është larg nga të qenit i kënaqshëm.

Tabela 6: Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor									
Mjedisi	2007/2008		2008/2009		2009/2010		2010/2011		
	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	Nom	Real	
Ndryshimi nominal dhe real % VnV	29.6	18.6	23.7	26.8	-18.5	-21.2	-31.1	-35.8	-2.9
	2007	2008	Ndryshimi nga viti i fundit	2009	Ndryshimi nga viti i fundit	2010	Ndryshimi nga viti i fundit	2011	Ndryshimi nga viti i fundit
Pesha në Buxhetin e Përgjithshëm të Shtetit	1.3	1.1	↓	1.1	< >	0.9	↓	0.5	↓

Siç tregon tabela 6, vetëm rreth 1% e buxhetit të përgjithshëm të shtetit shkon në financim të aktiviteteve mjedisore. Për më tepër, përveç 2008/2009 kur kishte një ngritje të vogël, dy vitet e fundit kanë sjellë ulje në buxhetin e Ministrisë dhe proporcionit të saj në buxhetin e përgjithshëm të shtetit. Përveç kësaj, pavarësisht se ka një proporcion të vogël, pesha në buxhetin e përgjithshëm të shtetit ka rënë në 0.57% në vitin 2011 (shih tabelën 6). Duke pasur parasysh që standardet në fushën e ambientit janë të shoqëruara me kosto të lartë financiare, me këtë buxhet duket e pamundur që të zbatohen në mënyrë progresive standardet evropiane në këtë fushë.

Tabela 7: Peshë në BPSH (%)				
Institucioni	Ndryshimi VnV % (2008/2009)	2008	2009	Trend
Agjencioni Kundër Korrupsionit (AKK)	10.50	0.039	0.035	↓
Agjencioni i Prokurimit Publik (PPA)	19.39	0.02	0.014	↓
Ministria e Drejtësisë	20.84	2.092	1.663	↓
Instituti Gjyqësor i Kosovës	25.08	0.036	0.029	↓
Administrata Tatimore	13.42	0.53	0.49	↓
Instituti i Kosovës për Administratë Publike	6.0	0.014	0.09	↓

VI. Rekomandimet e politikave

1. Është shumë e rëndësishme që gjatë përgatitjes së buxhetit, Qeveria e Kosovës t'i përmbahet modelit të bazuar në prioritete, duke i dhënë theks të veçantë prioriteteve që dalin nga Raportet e Progresit të KE-së për Kosovën. Në lidhje me këto të fundit, është thelbësore që Qeveria të përmbahet nga bërja prioriteteve të fushave politike 'me orientim partiak' deri sa marginalizon prioriteteve të shtet-ndërtimit që dalin nga raportet e progresit për Kosovën. Andaj, Qeveria duhet të përmirësojë në mënyrë strikte vendim-marrjen sa i përket shpërndarjes së buxhetit, duke i ofruar hapësirë të mjaftueshme prioriteteve shtetërore para atyre që kanë synim mbështetjen elektorale;
2. Siç është vërejtur dhe evidentuar nga Raporti i Politikave, alokimi i buxhetit ka lejuar për një rritje të jashtëzakonshme në disa sfera të politikave si transporti/infrastruktura, përderisa ka pasur vetëm rritje të vogël në alokimin e fondeve për prioriteteve kyçe të raporteve të progresit si anti-korrupsioni, drejtësia, prokuroria publike, etj. Prandaj, Qeveria duhet të mbajë një ekuilibër të fortë në rritjen e buxhetit për secilin sektor, sidomos për ato që shënohen si prioritete të dala nga raportet e progresit, duke bërë të mundur një rritje të balancuar dhe proporcionale të buxhetit mes sektorëve si transporti dhe sundimi i ligjit;
3. Siç është theksuar nga Raporti i Politikave, edhe pse buxheti për disa prioritete evropiane është rritur lehtësisht në terma nominal, një analizë ekonomike ka shfaqur se buxhetet e këtyre sektorëve janë ulur në terma real. Me të thënë këtë, ligji i buxhetit të Kosovës duhet në mënyrë eksplicite të thotë që nuk duhet të ketë ulje në buxhetin e OB-ve me prioritet evropian në terma real, në krahasim me vitin paraprak, duke lejuar kështu që OB-të e sipërpërmendura të kenë aktivitetet të qëndrueshëm me nivel të njëjtë të buxhetit. Qeveria dhe Ministria e Integrimit Evropian duhet të prezantojnë një mekanizëm vlerësimi për të kontrolluar nëse buxheti real për OB-të me prioritet evropian është ulur në krahasim me vitin paraprak;
4. Siç është evidentuar nga ky Raport i Politikave, nuk duket se ka koordinim mes OB-ve përgjegjëse për adresimin e prioriteve evropiane në hartimin e buxhetit të shtetit, duke

shtuar se Plani i Veprimit për Partneritet Evropian nuk ka vlerësim financiar për secilën nga linjat e veprimit. Me të thënë këtë, me qëllim të përmirësimit të dukshëm të zbatimit të standardeve të kërkuara nga raportet e progresit, duhet të prezantohet një model më kredibil për politikë-bërje buxhetore për të trajtuar prioritetet evropiane me më shumë përgjegjësi. Praktika aktuale e buxhetimit të prioritetëve evropiane duhet të rishikohet. Ne propozojmë këtë mekanizëm të ri. Së pari, secila OB me prioritet evropian bën vlerësim financiar të linjës së veprimit, brenda linjave të saj në ACEP, dhe ofron një propozim të plotë mbi nevojat financiare për të arritur ato caqe; së dyti, tavanet buxhetore për OB-të me prioritet evropian duhet të vendosen mbi bazat e prioritetëve të raporteve të progresit, dhe duhet të menaxhohen nga një grup i institucioneve, në mënyrë konsensuale, ku përfshihen Ministria e Integritetit Evropian, Ministria e Financave, Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian dhe ai për Buxhet dhe Financa, vetë organizatat buxhetore me prioritet evropian, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe organizata të shoqërisë civile në Kosovë; së treti, tavanet buxhetore të caktuara nga ky grup joformal i përmendur më lart, përcillen në buxhetin e shtetit pa ndërhyrjen e Qeverisë apo Kuvendit. Duket e vështirë që shqetësimet e raporteve të progresit janë duke u adresuar në mënyrë konsistente nëse vërehet që Ministria e Financave vendos vet në bazë të interesave të veta mbi tavanet e OB-ve me prioritet evropian;

5. Është shumë e rëndësishme që Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian të organizojë sesione dëgjimore të rregullta me Ministrinë e Financave mbi projekt-buxhetin, për të parë nëse prioritetëve të raportit të progresit u është dhënë hapësirë e mjaftueshme duke u bazuar në vlerësimet financiare të OB-ve me prioritet evropian. Komisioni duhet gjithashtu të kontrollojë nëse ka një balanc mes ngritjes proporcionale të prioritetëve politike sikurse transporti dhe buxhetit të prioritetëve evropiane sikurse gjyqësori apo politikat e konkurrencës;
6. Për t'u siguruar që çështja e buxhetimit të prioritetëve të raportit të progresit mbetet në krye të agjendës, Komisioni Evropian duhet të dizajnoj një kapitull të ri në raportin e progresit për Kosovën ku vlerësojnë integritetin dhe besueshmërinë e shpërndarjes buxhetore në kontekst të prioritetëve evropiane për Kosovën. Kjo do të mundësonte që çështja e buxhetimit të prioritetëve evropiane në Kosovë të bëhet gjithashtu edhe kushti për integritet për Qeverinë e Kosovës, duke bërë kështu të mundur vlerësimin e përmbushjes së kritereve të shtet-ndërtimit në mënyrë me efikase. Në anën tjetër, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë duhet të përfshihet në mënyrë më të drejtpërdrejtë në procesin e monitorimit dhe dizajnit të buxhetit të Kosovës, duke bërë presion në qeveri për t'i alokuar fondet në mënyrë më proporcionale në politikat prioritare të raporteve të progresit për Kosovën.
7. Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian duhet të bëjë një shqyrtim vjetor të buxheteve të OB-ve me prioritet evropian për ndonjë suficit të mundshëm. Nëse evidentohet që OB-të me prioritet evropian kanë suficit në buxhetet e tyre vjetore, siç është rasti për momentin, duhet menjëherë t'i rekomandojë Kuvendit që të kërkojë llogaridhënie

nga këto OB për mungesë të performancës së tyre në financimin e aktiviteteve të tyre në mënyrën e duhur;

8. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm duhet të themelojë një departament të ri, të quajtur Departamentin për Integritet Evropian, përmes të cilit do të vlerësoj dhe monitoroj për çdo vit performancën e buxheteve të OB-ve me prioritet evropian. Kjo do të mundësonte matjen nëse shpenzimet e bëra në fushat e politikave me prioritet evropian e kanë efikasitetin dhe rregullsinë e nevojshme. Raportet e tilla duhet të shqyrtohen dhe të përdoren për llogaridhënie politike nga Komisioni Parlamentar për Integritet Evropian;
9. Kuvendi, Komisionet Parlamentare për Integritet Evropian dhe ai për Buxhet dhe Financa, si dhe Ministria për Integritet Evropian duhet të themelojnë mekanizma për llogaridhënie për të vlerësuar performancën dhe zbatimin e buxheteve të OB-ve me prioritet evropian. Kjo do të sigurojë që performanca e këtyre të fundit ndjek principet e llogaridhënies dhe efikasitetit.

Viti	2007		2008		2009		2010		2011	
Shpenzimet e Buxhetit të Përgjithshëm të Shtetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit
	764,272,638	743,455,874	1,161,750,967	1,033,586,270	1,423,928,847	1,298,020,827	1,350,216,753	1,189,618,285	1,509,886,567	1,239,644,144
	2007		2008		2009		2010		2011	
Institucioni/Fusha	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit	Alokimi nominal i buxhetit	Alokimi real i buxhetit
Ministria e Infrastrukturës	35,766,968	34,792,770	139,394,085	124,016,090	160,980,517	146,746,141	207,728,288	183,020,518	276,510,991	227,020,518
Ministria e Edukimit	50,326,303	48,955,548	70,037,591	62,311,024	55,441,554	50,539,247	43,458,825	38,289,714	36,789,985	30,205,242
Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor	9,596,461	9,335,079	12,440,973	11,068,481	15,389,929	14,029,106	12,547,262	11,054,856	8,638,717	7,092,543
Ministria e Bujqësisë	7,270,137	7,072,118	9,947,615	8,850,191	13,339,298	12,159,798	11,988,529	10,562,581	13,962,958	11,463,841
Sundimi i Ligjit:										
KRPP	336,126	326,971	330,170	293,746	314,336	286,541	293,854	258,902	326,523	268,081
AKK	382,439	372,022	456,600	406,228	504,553	459,939	504,338	444,351	534,351	438,712
APP	153,036	148,868	164,098	145,995	155,870	142,088	157,058	138,377	161,617	132,690
Police	57,604,800	56,035,798	60,050,104	53,425,359	54,779,154	49,935,418	63,540,059	55,982,431	74,782,072	61,397,432
OSHP					526,071	479,554	286,222	252,178	273,308	224,391
Drejtësia:										
Ministria e Drejtësisë	15,989,941	15,554,417	19,322,202	17,190,571	23,092,639	21,050,719	22,937,187	20,208,975	20,915,517	17,172,017
Drejtësia/Prokurori i Shtetit	1,811,818	1,762,469	1,502,358	1,336,617	1,039,727	947,791	112,723	99,315	4,732,469	3,885,443

Instituti Gjyqësor i Kosovës	272,995	265,559	341,468	303,797	612,425	558,273	577,091	508,450	512,515	420,784
Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës	9,340,378	9,085,971	12,348,643	10,986,337	14,608,746	13,316,997	15,172,791	13,368,098	18,214,792	14,954,673
Tjera										
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	3,601,263	3,503,174	5,745,138	5,111,333	9,220,857	8,405,521	9,660,158	8,511,152	7,280,842	5,977,703
Administrata Tatimore			6,183,538	5,501,368	7,013,063	6,392,947	7,066,135	6,225,670	7,156,868	5,875,918
OEK					205,900		187,694	243,884	214,876	197,289
IKAP	164,145	159,674	163,050	145,062	131,050		119,462	138,884	122,365	131,093
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	8,064,766	7,845,103	11,743,508.00	10,447,960.85	12,181,728		11,104,583	12,356,657	10,886,922	10,775,245

Legjenda	
Agjencia Kundër Korrupsionit	AKK
Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	KRPP
Agjencia e Prokurimit Publik APP	APP
Organi Shqyrtues i Prokurimit	OSHP
Instituti Kosovar i Administratës Publike	IKAP

Tabela 8: Buxheti i përgjithshëm i shtetit dhe institucioneve, nominal dhe real gjatë periudhës 2007-2011

Analiza e Politikave

Analiza e Politikave në përgjithësi është një raport me këshilla politike të cilat synojnë të ndikojnë mjetet kyçe përmes të cilave bëhen vendimet e politikave në nivelet lokale si dhe ato qendrore të qeverisë. Qëllimi i Analizës së Politikave është të adresojë një problem të veçantë, më në thellësi, për të shqyrtuar argumentet e ndërlidhura me politikën përkatës, dhe të analizojë zbatimin e asaj politike. Përmes Analizës së Politikave, Grupi për Studime Juridike dhe Politike synon të stimulojë debat më të gjerë, gjithëpërfshirës, mbi çështjen e dhënë duke ofruar zgjidhje të informuara relevante për politikën dhe rekomandime për aktorët dhe palët kyçe të interesit.

